



VENDIM PËR PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 5 qershor 2012

Numri i lëndës 2012-01

Z. Qamil Hamiti

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 5 qershor 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, ushtruese detyre e kryesuesit
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, dhe Rregulloren e Punës së Panelit të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 7 shkurt 2012.
2. Paneli ka shqyrtuar ankesën më datën 5 qershor 2012. Paneli ka vendosur rreth ankesës me dy anëtarë të pranishëm, sipas Rregullës 14 § 3 të Rregullores së Punës.

II. FAKTET

3. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve që janë në dispozicion të Panelit, mund të përmbliken si në vijim.

Historiku

4. Parashtruesi i ankesës është kryetar i Sindikatës së pavarur të ndërmarrjes shoqërore (NSh) "Jugotherm në Gjilan. Ai është duke u kujdesur rreth interesit të punëtorëve të kompanisë, të cilët do të përfitonin materialisht prej realizimit të privatizimit të kompanisë.

Procedura tenderuese e vitit 2006

5. Në qershor të vitit 2006, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ka nisur një procedurë tenderuese për NSh "Jugotherm", e cila përbëhej prej një fabrike radiatorësh në Gjilan. Në mesin e tre ofertuesve, tenderi ishte fituar nga kompania private "ENG Office".
6. Për shkak të dyshimit për veprime joligjore në lidhje me procesin tenderues nga ana e palëve në procedurat tenderuese, tenderi ishte shpallur i pavlefshëm nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjS) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit më 8 gusht 2007. Në përputhje me ligjin, mbeti që të vendosej nga AKM-ja për ta rihapë tenderin, nëse do të bënte zgjedhje të tillë.
7. Më 5 shkurt 2008, DhPGjS ka hedhur poshtë kërkesën për rishikim të bërë nga "ENG Office". Ishte konstatuar se vendimi i datës 8 gusht 2007 ishte vendim përfundimtar. "ENG Office" më herët nuk ishte pjesë e procedurave pranë DhPGjS, përveç si parashtrues i kërkesës për rishikim.

Procedurë për zbatimin e masës së përkohshme

8. Më 17 tetor 2008 "ENG Office" ka dorëzuar një kërkesë për zbatimin e një mase të përkohshme që mos të lejohet Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) për të rihapur procedurat tenderuese për NSh.
9. Më 17 nëntor 2008, DhPGjS miratoj zbatimin e masës së përkohshme e cila ishte kërkuar, pasi në fakt "ENG Office" mund të pësonte dëme të pariparueshme nëse procesi do të ishte hapur përsëri dhe NSh do t'i ofrohej ofertuesit tjetër.
10. Më 9 dhjetor 2008, DhPGjS ka hedhur poshtë kërkesën për rishikim të bërë nga AKP.

Shqyrtim i ri pranë DhPGjS

11. Më 22 tetor 2009 DhPGjS ka vendosur që "ENG Office" ishte konfirmuar si ofertues fitues i tenderit për privatizimin e NSh në fjalë. AKM dhe AKP ishin të detyruara të realizonin tenderin me "ENG

Office”. Përpos kësaj, AKM ishte e detyruar t’ia kompensoj dëmin “ENG Office”.

12. AKM ka ushtruar ankesë kundër këtij vendimi. Më 7 tetor 2011 Paneli për Ankesa i DhPGjS ka hedhur poshtë ankesën.

III. ANKESAT

13. Parashtruesi i ankesë pretendon që për shkak të dyshimit të veprimeve të paligjshme nga kompania “ENG Office” dhe të tjerëve, oferta fituese e bërë nga “ENG Office” ishte rreth 20% më e ulët sesa që duhej të ishte. Si rezultat, aksionet e punëtorëve që dalin nga privatizimi do të ishin rreth 20% më të ulëta sesa që ato duhej të ishin nëse oferta do të ishte e drejtë.
14. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që vendimi i datës 7 tetor 2011 nga ana e Panelit për Ankesa i DhPGjS mos të zbatohet. Ai nuk dëshiron që kompania “ENG Office” të bëhet pronar i NSh në procedurën e privatizimit.

IV. LIGJI

15. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së vet të Punës.
16. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së vet të Punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
17. Çështja e ngritur në këtë ankesë ka të bëjë me pakënaqësinë e punëtorëve të NSh “Jugotherm” sa i përket çmimit të kompanisë të pranuar në procedurën e privatizimit të asaj kompanie. Nuk është treguar apo argumentuar se EULEX-i në Kosovë ka qenë i përfshirë në çfarëdo cilësie në lëndën e parashtruesit të ankesës.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar këtë ankesë,

gjen se sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës, ankesa është e pabazuar, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Ushtruese detyre e kryesuesit të Panelit